



19 APR 2022

Nr. 1267 Regj Nr. 727 Prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT AEF SH.P.K

URDHËR

"për vënien e sekuestros konservative"



Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit
Për dijeni : Shoqëria "Aurea Strategies" shpk me Nipt L82306028C
Për dijeni : Shoqëria "Qafshtama" shpk

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Privat "AEF" sh.p.k. me kërkesë të palës kreditore është regjistruar cështja përmbarrimore me palë :

Debitor : Shoqëria "Aurea Strategies" shpk me Nipt L82306028C
Kreditor : Shoqëria "Qafshtama" shpk
Objekt : Përmbushje detyrimi

Unë Përmbarruesi Gjyqësor Emiljano A Gjoza pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbarrimore,

KONSTATOVA :

Për titullin ekzekutiv "Fatura Tatimore të shitjes me nr 217918940 , datë 21.10.2019 në vlerën 4,788 lekë; fatura nr.217933698 , datë 06.11.2019 , në vlerën 6,840 lekë ; fatura nr.217933824 , datë 25.11.2019 , në vlerën 6,840 lekë ; fatura nr.217933974 , datë 13.12.2019,në vlerën 5,472 lekë; fatura nr.217934104 , datë 25.12.2019 , në vlerën 7,524 lekë ;fatura nr. 217934391 , datë 25.01.2020 në vlerën 6,840 lekë", në zbatim të cilit është lëshuar urdhëri i ekzekutimit Nr.7323 datë 01.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar procedura përmbarrimore..

Pasi kanë kaluar afatet e parashikuara ligjore dhe debitori nuk e ka përmbushur detyrimin, në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros konservative në kuotat që zotëron pala debitore : Shoqëria "Aurea Strategies" shpk me Nipt L82306028C me qëllim mostjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar.

Per kete arsye si dhe në bazë të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHEROJ :

1. Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë masën e sekuestros konservative në kuotat që zotëron pala debitore **Shoqëria "Aurea Strategies" shpk me Nipt L82306028C** me qëllim mostjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar.
2. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër mbahet ne 4 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brënda 5 ditëve nga marja dijeni.

Zyra e Përmbarrimit Privat AEF shpk

Përmbarruesi Gjyqësor Privat

Emiljano A Gjoza